



Shkollën Foko Gen3 2020
PROPOZIME
PËR ASAMBLENË 2020




nga Gen3 të 29 Vendeve
të bashkuara për shkollën Foko në Trento



A

**“Çfarë Kontributi
përtëritës mund të japim
si Lëvizje gen 3 për të
realizuar
një botë të bashkuar së
bashku me gjithë pjesën
e rritur të Veprës?”**



A1

Un nostro contributo:
**TË SHTOJMË DUKSHMËRINË E
LËVIZJES**

Të bëjmë që sa më shumë persona të jetë e mundur ta njohin Idealën si në botën tonë të vogël ashtu edhe në nivel botëror, të ftojme të rinj, persona të besimeve të tjera, jo besimtarë.

SI?

> Duke prezantuar Idealën dhe vlerat tona.

- >> Të organizojmë prezantime në shkolla, në famulli
- >> Të prezantojmë më shumë dhe më mirë Lëvizjen gen3

> Duke përfshirë persona të tjerë në veprimet tona.

- >> Të organizojmë slot mob
- >> Të zhvillojmë projektet tona: sport4peace, living peace, artin e dashurisë, t'i japim ngjyra qytetit...
- >> Të shtojmë takimet dhe veprimet me të rinjtë që nuk e njohin Idealën

> Duke organizuar takime të hapura për personat e rinj.

- >> Kantiere Hombremundo vendas dhe botërore dhe kampime për të ftuar persona të rinj.

> Me mjetet e komunikimit.

- >> Të përdorim më shumë mjetet e komunikimit që ta bëjmë Lëvizjen të njihet.
- >> Të përhapim idetë tona nëpërmjet mediave sociale, programeve TV, revistës Teens, këngëve, të propozojmë flash mob

> Me dëshminë personale.

- >> Të lexojmë dhe të jetojmë Ungjillin, të bashkëndajmë përvojat tona personale.
- >> Të përhapim idealin duke dashur, duke jetuar Ungjillin në mënyrë që familja e idealit të rritet.

A2

Un nostro contributo:
**IMPAKTI
 KONKRET**

Të kemi një impakt konkret mbi problemet që e hidhërojnë botën mbarë (luftërat, konsumizmi i tepërt, ngrohja globale, ndotja, varfëria, paligjshmëritë...).

SI?

>> **Të promovojmë:** Uria zero, Plastika Zero, Shpyllëzimi Zero...

>> **Të bashkëpunojmë në projektet** e ndihmës kundrejt të pastrehëve, të ndihmojmë fëmijët dhe adoleshentët e pambrojtur...

>> Të luftojmë për **arsimimin** në botë.

>> Të realizojmë aktivitete që të ndihmojnë **refugjatët**.

>> Të bëjmë që **të njihet** sa më shumë të jetë e mundur situata në botë, ndoshta me lidhje CH më të shkurtra.

>> Të shtojmë **angazhimin tonë në fushën sociale**, por duke ruajtur vlerën themelore të formimit personal. .

ME KË?

>> Duke shtuar rastet **e ndihmës së ndërsjellë mes breznive të ndryshme** dhe angazhimit të përbashkët në veprimet sociale, të shtohet projektimi i veprimeve.

>> Të promovojmë dialogun, mbështetjen dhe besimin e ndërsjellë mes breznive **për të arritur së bashku objektivat konkretë**.

>> Të bëjmë veprime koherente për të përmirësuar botën **duke filluar nga bashkësitë tona lokale** me të rriturit dhe fokolaren.

>> Të bashkëpunojmë me **organet e rëndësishme të qyteteve tona**.

>> Të përforcojmë **marrëdhëniet me institucionet botërore:**

OKB, UNESCO, FAO (për të përhapur apo mbështetur veprimet ekzistuese).


A3

Un nostro contributo:
**TË KTHEJMË
 ENERGJI**

> **T'I JAPIM GEN 1 DHE PRINDËRVE KURAJON TË VAZHDOJNË ME FOKOLARËT.**

> **T'U JAPIM SHPRESË GEN1 ME PRANINË TONË TË FORTË, ME PJESËMARRJEN DHE KURAJON TONË.**

> **TË KTHEJMË ENERGJI: MË PËRPARA KJARA THOSHTË ÇFARË DUHEJ TË BËNIM, TANI NA TAKON NEVE TË MARRIM NISMËN.**



A4

Un nostro contributo:
BASHKIMI I PASURIVE

- >> **Të intensifikojmë bashkimin e pasurive** që të jetë sa më i qëndrueshëm jo vetëm në degën e gen 3 por në të gjitha degët e Veprës.
- >> **Të promovojmë kasat gen3** për gen3 që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në kongreset apo në rastet e tjera dhe për të lejuar që të realizohen kongreset në vendet që kanë më shumë vështirësi.
- >> Të reflektojmë mbi **problemin ekonomik** të botës (për shembull klimën etj.).

A4


Un nostro contributo:
DEPËRTIMI NË SHKOLLAT

- >> Të bëjmë takime dhe **prezantime në shkollat** që fëmijët ta njohin Lëvizjen. Të nënvizojmë se është për të gjitha besimet.
- >> Të përhapim në shkolla disa “club” që të mbartin kulturën tonë, si “**Teens4unity Club**”.
- >> Të trajtojmë **argumenta aktualë** nga perspektiva e karizmës së bashkimit (bulizmi, depresioni, ankthi...).

A5

Un nostro contributo:
MEDIAT SOCIALE

- >> Të jemi të hapur, **të komunikojmë**, të jemi të pranishëm në social network.
- >> **T'i paraqesim në mënyrë të arritshme**, më moderne dhe tërheqëse idetë e Lëvizjes për të arritur sa më shumë persona.
- >> Ne gen3 mund të dhurojmë **një shikim të ri** dhe të ndihmojmë të rriturit me njohjen tonë të rrjeteve sociale.
- >> Të bëjmë një “app” me një rregjistër të takimeve të njësisë gen, një “kujtesë” ku secili ka një emër llogari dhe **mundësinë të bashkëndajë dokumenta** dhe shkrime... me njësinë e vet apo me gen të tjerë.
- >> **Të promovohet dialogu ndërmjet besimeve.**



B

“A keni ide të reja origjinale se si do të mund të na ndihmonin gen 2 dhe gen 1 për të na shoqëruar në rritjen personale dhe si Lëvizje Gen3/RpU?”



B1

Un nostro contributo:
**TË JEMI MË TË BASHKUAR
 NDËRMJET BREZNIVE TË NDRYSHME**

Marrëdhënie të vërteta me të gjithë personat e Veprës.

- > **Të takohemi së bashku** më shpesh mes brezrave të ndryshme. Të kërkojmë një shkëmbim idesh dhe përvojash.
- > Të propozojmë krijimin e ekipeve të vogla në çdo zonë të vogël në të cilën marrin pjesë të gjitha brezat.
- > Të shtojmë momentet së bashku me vullnetarët dhe gen-ët.
- > Të kërkojmë **hapësira për dialog** me të rriturit.
- > Të përfshijmë gen2 dhe gen1 në takimet me gen3 edhe nëpërmjet disa përfaqësuesve.
- > Ashtu si ne, gen 3, jemi një dhuratë për të rriturit, edhe ata janë një dhuratë për ne! Takime me të gjitha thirrjet dhe brezat ku të **shkëmbehen përvojat** dhe atë që kanë mësuar mbi Idealin (pa hequr momentet specifike sipas brezave). Në këta takime të ekzistojë mundësia e ndërveprimit më të brendshëm me atë që tregon një përvojë, në grupe më të vegjël në mënyrë që të gjithë të mund të shprehen dhe të bëjnë pyetje.
- > Që gen 2, gen 1 dhe bashkësia **të konsiderojë më shumë gen 3.**
- > Të rriturit duhet të kenë **më besim** në gen 3.
- > **Të bëhen festat së bashku** (të Krishtlindjes apo të tjera), për t'u njohur më mirë sepse nëse nuk njihemi nuk mund të mësojmë nga ata.
- > Të bashkëndajmë më shumë momente me të rriturit duke bërë **aktivitete së bashku**. Të promovojmë veprime kolektive, **të vendosim disa objektiva të përbashkët** për të arritur të sensibilizojmë njerëzit me idealin tonë të dashurisë (e kemi këtë mundësi edhe në nivel botëror!).



B2

Un nostro contributo:
**ASISTENTËT
 TANË**

- > Që Gen 2 të jenë asistentët e Gen 3.
- > Të kemi një pikë referimi (një asistent) **që të jetë më i gatshëm për gen 3** dhe të mund të tregojë të gjitha përvojat që ka jetuar.
- > Gen 1 dhe Gen 2 duhet të jenë për Gen 3 **persona në të cilët të kemi besim** dhe që të na marrin seriozisht. Persona që të jenë një shembull në jetën e Idealit dhe në jetën e krishterë.
- > Të emërohet një asistent që **të mund të ndihmojë fokolarinin/en.**
- > Do të na pëlqente të ishim të pranishëm në zgjedhjen e asistentëve të gen 3 dhe të kishim një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me kreun e zonës kur e shohim që asistenti ynë po kalon disa **vështirësi personale.**

B3

Un nostro contributo:
**EPIDEMIA SHKOLLA
 DHE KANTIËRE**

- > Të përsëriten shkolla si kjo, kongrese me më pak persona dhe më të shpeshta, në çdo krahinë, për **të favorizuar pjesëmarrjen dhe zvogëluar shpenzimet.**
- > Të bëhen **kantiere Hombro Mundo** edhe në Zonat tona dhe Zonat e mëdha.
- > Të organizohen më shumë kongrese dhe **shkolla ndërkombëtare të përziera.**

B4

Un nostro contributo:
**BASHKIM
 DHE BASHKËPUNIM ME GEN2**

- > Kemi nevojë të **qëndrojmë së bashku me gen2.**
- > Duam të kemi më shumë asistent gen2 që **të mbështesin asistentët e rritur.**
- > Do të donim **një bashkëpunim më të madh** me gen2 që janë shumë më pranë nesh.

B5


Un nostro contributo:
**AKTIVISTË TË
 BOTËS SË BASHKUAR**

- > Të shkojmë më në thellësi **me kulturat e ndryshme** me objektivin që të përhapim Idealin dhe të arrijmë vëllazërinë universale (me muslimanët, hebrenjtë, budistët, etj.)
- > Bashkimin **ndërmjet familjeve** të kulturave të ndryshme për të mësuar të duam larmishmërinë.
- > Të krijojmë raste për të përhapur Lëvizjen në mënyrë **që të njihet edhe nga personat e Kishave të tjera.**
- > Të realizojmë aktivitete të veçanta (për shembull kampime) në të cilët të flitet për Idealin e Lëvizjes dhe idenë e Botës së Bashkuar në një mënyrë përtëritëse që të mund të tërheqë personat që nuk kanë një referim fetar dhe **personat ateistë.**
- > T'u komunikojmë Idealin edhe personave të **besimeve të tjera** dhe të thellojmë karizmën e besimeve që Ideali t'u arrijë edhe atyre.
- > Të kujdesemi për anëtarët apo bashkëpuntorët e **besimeve të tjera.**
- > T'u kërkojmë ndihmë të rriturve që gen-ët të mund të marrin pjesë më shumë në **politikë** për t'u bërë "aktivistë të botës së bashkuar"



B6

Un nostro contributo:
**NDIHMË PËR
PROJEKTET**



- > Të na ndihmojnë në mënyrë që projektet që propozojmë të **realizohen**, domethënë, që të bëhen me rregullsi.
- > Të fillojmë nga qytetet tona (një qytet nuk mjafton!)
- > Të punojmë **së bashku** me të rriturit e Lëvizjes në projekte (si për shembull të pastrohen plazhe apo në ndihmë të më nevojtarëve).
- > T'u kërkojmë Gen 2 dhe Gen 1 idetë që kanë funksionuar dhe si t'i përmirësojmë. **Kemi nevojë për udhëheqjen e tyre, dijen, mësimet dhe pikat e referimit të së kaluarës.**
- > **Çdo njësi** të angazhohet në një veprim social.
- > Të angazhohemi **me më rregullsi** për ambientin dhe për personat më në vështirësi.
- > Të përfshijmë më shumë gen-ët në aktivitete konkrete **ekzistuese**.
- > Aktivitete sociale të bëra së bashku me bashkësinë. Të ndihmojmë **bashkësitë lokale** që të bëjnë një program serioz. Për gjithë këtë nevojitet koha, durimi dhe mbështetja.
- > Të bashkëndajmë **programet e veprimeve sociale** të Gen3:
- >> Të punojmë së bashku me projektin **"Uria Zero"**, të angazhohemi konkretisht për ruajtjen e ambientit (për shembull të pakësojmë plastikën).
- >> Të bëjmë **olimpiada Gen ndërkombëtare** me të rriturit që shoqërojnë gen 3 në formimin e tyre praktik dhe teorik.
- >> Të rrisim projektin **Up2Me**.



B7


Un nostro contributo:
FORMIMI

- > Vepra është një ndërtesë që ne Gen 3 duhet të vazhdojmë të ndërtojmë dhe pra Gen 1 dhe Gen 2 duhet të na **transmetojnë themelet**. Nëse na japin idealin e vërtetë ne do të mund të vazhdojmë ta ndërtojmë Veprën dhe t'ua transmetojmë brezave të ardhshëm.
- > Të rrisim **formimin personal** tonë gen3 që të na bëjë të kryejmë zgjedhje të vetëdijshme në të gjitha fushat (zgjedhje jete pak a shumë të mëdha, ekologjike, politike, mentalitet bashkëndarës).
- > Kemi nevojë për ndihmën e të rriturve për t'u formuar mirë. Na nevojiten **përvojat e tyre për t'ia dalë të shohisim çfarë është mirë dhe çfarë është keq**.
- > Të jetojmë akoma më mirë Ungjillin dhe Idealin me Gen1, të dëgjojmë nga Gen 1 dhe Gen 2 **përvojat e tyre personale**.
- > T'u kërkojmë të rriturve dhe gen2 që të na ndihmojnë të **zhvillojmë idetë tona** dhe t'i bëjmë realitet. Të shtojmë workshop-ët që ata bëjnë për ne.
- > Të kërkojmë që të **na ndihmojnë në angazhimin tonë dhe në të konkretizuarit e ideve tona**.
- > Të kërkojmë që të bëhen **më shumë takime** (takohemi tepër rrallë).
- > Na inkurajoni që të shkojmë në takimet!
- > Duam të shprehim mendimin tonë përsa i përket organizimit të takimeve. Të kërkojmë ballafaqimin me të rriturit. **Të mbajmë së bashku përgjegjësitë** në kongreset.
- > Është e rëndësishme të kurojmë **takimet e hapura për të gjithë** që të jenë **tërheqës**. Të bëjmë gjëra **interesantë** që të tërheqin miqtë tanë.
- > Do të donim ndihmën e ekspertëve për **formimin njerëzor**.
- > Duam një **formim katekistik** për të njohur dhe për ta dashur Kishën.
- > Të realizojmë një shkollë gen veror mbi **tematikën e paqes**.



C

“Duke parë nevojat e botës së sotme çfarë do të donim t’i propozonim presidentes së re për të zhvilluar Lëvizjen në 6 vitet e ardhshme?”



c1

Un nostro contributo:

ALLA NUOVA PRESIDENTE

- > Të kemi gjithmonë në zemër idealet e **Kjarës**.
- > **Dhjetë vjeçari i ardhshëm do të jetë i ekologjisë: Lëvizja duhet të jetë protagoniste.** Të krijojmë vepra të reja sociale për të përfshirë sa më shumë njerëz dhe të bëjmë veprime ekologjike shumë konkrete.
- > **Të komunikojmë me një film jetën e Kjarës për të treguar se një botë e bashkuar është e mundur.**
- > **Film artistik** mbi gjithë jetën e Kjarës që të realizohet me gen 1, 2, 3, 4 dhe ndoshta edhe me ndonjë aktor më të njohur. Filmi të përhapet pastaj në mbarë botën.
- > Lëvizja do të duhej **të përmirësohet në organizim.**
- > Të mundësohet që Lëvizja të **përfshihet më shumë në politikën e jashtme.**
- > Të bëhet një **Fjala e Jetës** me një gjuhë universale (përveç asaj që kemi çdo muaj) që mesazhi të arrijë sa më shumë persona (të feve dhe besimeve të tjera).
- > Të kemi gjithmonë si **përparësi ndihmën kundrejt personave.**
- > **Të përfshijmë gen3 të mëdhenj në Asamblenë** për të përmirësuar bashkimin në brendësi të Lëvizjes, të kemi një kontakt më të madh mes gen3 dhe gjithë Lëvizjes

c2


Un nostro contributo: **MARRËDHËNIE MË TË MADHE ME PRESIDENTEN**

- > **Prani më e madhe** e presidentes mes nesh, të rinjve, që ajo të jetë modeli ynë.
- > Presidentja nuk duhet të ketë frikë të njihet nga brezat e rinjë. Te jetë më e pranishme.
- > Të mundohemi ta njohim më mirë presidenten e re, më shumë **kongrese botërore** në të cilët ajo të jetë e pranishme.
- > Presidentja do të duhej të **udhëtonte më shumë** në botë.

c3

Un nostro contributo: **TË BALLAFAQOHEMI DUKE SHKËMBYER PËRVOJA**

- > Të bëhen më shumë takime **të shpeshta** në të cilët të tregojmë përvojat e Ungjillit.
- > Të ftojme të rriturit që të na tregojnë **përvojat e tyre me Kjarën**.
- > Lëvizja ka nevojë t'i japë më shumë zë **vizionit të Gen 3** se si po shkon bota sot, si për shembull realiteti aktual rinor.



c4

Un nostro contributo: **TË LIDHEMI**

- > Lëvizja duhet të jetë më e pranishme në Mediat. Të gjehen mënyra që të bëjmë të njihet, t'i bëjmë publicitet edhe nëpërmjet vidjove...
- > Të përdoren më shumë teknologjitë e reja (për komunikimin dhe marketingun) dhe rrjetet sociale (**instagram dhe Youtube**) për të përhapur idetë e Lëvizjes.
- > Të bëhet më **e dukshme prania e fokolarinëve në botë**. Të përhapet Lëvizja.
- > Të transmetohen çdo ditë lajmet e Lëvizjes në nivel botëror që të arrihen të gjithë dhe të promovohet Ideali mes të gjithëve.
- > Të veprohet në mënyrë që personat e Lëvizjes që i kushtohen rrjeteve sociale dhe mediave të jenë **persona të formuar dhe të kualifikuar** për ta bërë këtë punë në mënyrë profesionale.
- > Të propozojmë që të zhvillohen **platforma on-line për një bashkim botëror** që të vihen kështu në kontakt të gjithë gen3 dhe gen3 të botës për të bashkëndarë përvoja apo për të na përditësuar mbi ngjarjet.
- > **Të gjehen para** në mënyrë që të mund të përhapen gjithnjë e më shumë aktivitetet e Veprës nëpërmjet rrjeteve sociale.> Të përdoren gjithnjë e më shumë platformat dixhitale për të lëshuar më shumë **veprime në nivel botëror**.
- > **Të bëhen vidjo dhe filma** që personat të mund ta njohin Lëvizjen dhe qëllimet e saj, natyrisht me fjalë tërheqëse.



Propozime për Asamblenë 2020
të redaktuara nga Gen3 në "Shkollën Foko",
Trento 2-10 janar 2020.

Gen3 kanë punuar në 32 njësi gen,
të përzier sipas kombësive. Vijnë nga
Shqipëria . Argjentina . Bolivia . Brazili . Bullgaria . Kili
Kolumbia . Korea e Jugut . El Salvadori . Filipinet . Gjermania
Britania e Madhe . India . Toka e Shenjtë . Italia . Libani
Maqedonia . Meksika . Panamaja . Paraguaji . Portugalia
Rumania . Slovakia . Spanja . Svicera . Ukraina . Uruguai
S.H.B.A. . Venezuela .

centrogen3f@focolare.org
gen3m@focolare.org
centro.rpu@focolare.org

